




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 3, 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe 47 paragrafi 1 dhe 48 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2025, mori këtë,

V E N D I M

PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

1. **z.Isak Shabani**, Kryesues i Kuvendit (sipas pozitës)
2. **z.Haki Rudari**, anëtar nga subjekti politik LVV
3. **z.Artrit Mulliqi**, anëtar nga subjekti politik LVV
4. **znj.Adelinë Stublla**, anëtare nga subjekti politik LVV
5. **znj.Qëndresë Hajrizi**, anëtare nga subjekti politik LVV
6. **znj.Alisa Jetullahu**, anëtare nga subjekti politik LDK
7. **z.Enis Shabani**, anëtar nga subjekti politik LDK
8. **z.Ekrem Rrahmani**, nga subjekti politik LDK
9. **znj.Mimoza Abdullahu**, anëtare nga subjekti politik PDK

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual mund të bëhen me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 4

Kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, bëhet konform legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot.01-016/01-0082947/25
Podujevë, datë; 29 dhjetor 2025

